



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
30.03.2026

Me datë 30.03.2026, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Edmond Ndou, Jona Leqejza, Uarda Gjekaj, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Daniela Jakoja, Ardit Taflaj, Alma Mehmetaj, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Erlinda Kavaja, Gjovalin Ndoj, Florian Bjanku, Irena Shala, Valjeta Bajraktari, Artan Haxhi, Izmira Rusi, Ardit Behri, Glorja Shllaku, Elmira Ndervashaj, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Jetmira Rraboshta, Ervin Brahimi, Violeta Perndrecaj, Sead Jusha, Suada Kopshti, Fatmir Vojvoda, Muharrem Shkjau, Amina Lici, Blendi Gjylbegaj. Ardita Spahija.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. *Projektvendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shkurt 2026”.*
2. *Projektvendim: “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër për vitin 2026”.*
3. *Projektvendim: “Për një ndryshim në VKB-në nr.8 datë 26.01.2026 “Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë e tregut të lirë për vitin 2026”.*
4. *Projektvendim: “Për një ndryshim në VKB-në nr.84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar.*
5. *Projektvendim: “Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Shkodër”.*

6. *Projektvendim: "Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 për Bashkinë Shkodër"*.
 7. *Projektvendim: "Për miratimin e programit të transparencës në Bashkisë Shkodër"*.
 8. *Projektvendim: "Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në Bashkinë Shkodër për Bashkinë Shkodër"*.
 9. *Projektvendim: "Për miratimin e planit lokal, programi 5-vjeçar i strehimit social 2026-2030, në Bashkisë Shkodër"*.
 10. *Projektvendim: "Për miratimin e planit të mbrojtjes sociale 2026-2030, në Bashkinë Shkodër"*.
 11. *Projektvendim: "Për miratimin e planit lokal të Rinisë 2026-2030, në Bashkisë Shkodër"*.
 12. *Projektvendim: "Për miratimin e planit vendor të veprimit në barazinë gjinore 2026-2030, në Bashkinë Shkodër"*.
 13. *Projektvendim: "Për një ndryshim në VKB-në nr.22, datë 18.04.2019 "Për miratimin e planit lokal për veprimin e zhurmës në mjedis", i ndryshuar të Bashkisë Shkodër"*.
- *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Kourumi i domosdoshëm është prezent në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

Z. Luli bën leximin e rendit të ditës.

Vijohet me votimin e rendit të ditës, ku rezultojnë **34** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Po ashtu para se të kalohet tek pikat e rendit të ditës vijohet me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak, datë 27.02.2026 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", neni 16 pika 2.

Procesverbali hidhet në votim, ku rezultojnë **33** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika e parë e rendit të ditës: *Projektvendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shkurt 2026"*.

Znj.Pode shprehet, që tre pikat e para të rendit të ditës nuk kanë nevojë për relativitet, prandaj propozon që të kalohet direkt me votimin e tyre.

Kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve për pikën e parë, ku të gjithë shprehin dakordësi me projektaktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **34** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 2: *“Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër për vitin 2026”*.

Edhe kjo pikë nuk ka nevojë për relativim, prandaj kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projektaktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **34** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikë 3. të rendit të ditës: *“Për një ndryshim në VKB-në nr.8 datë 26.01.2026 “Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë e tregut të lirë për vitin 2026”*.

Kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve ku Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehin dakordësi me projektaktin, kurse **Znj.Shala** shprehet se te ky projekt vendim ka një korrigjim, ka një formulë llogaritjeje gabim, prandaj ajo dëshiron të ketë një sqarim se kush humb dhe kush fiton nga kjo?

Znj.Shoshi, drejtoreshë e përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit në Bashkinë Shkodër sqaron duke thënë se kemi të bëjmë thjeshtë me një lapsus, dhe nuk ka asnjë ndryshim, as tek lista emërore e përfituesve dhe as në pagesa me vendimin e miratuar në janar të këtij vitit. Thjeshtë është bërë një gabim formule, i cili më pas ka rrjedhë edhe në buxhet por që është më pak dhe jo më shumë se vlera, gjithsesi gabimi është vënë re në momentin e përgatitjes së dokumentacionit të likujdimit, i cili nuk është bërë akoma sepse edhe fondi nuk ka ardhur akoma nga ministria për të vijuar me likujdimin.

Përsëri **Znj.Shala**: Nga ajo që kemi miratuar me këtë tani kush humbet dhe kush fiton?

Përgjigjet **Znj.Shoshi**: Nuk humbet askush, janë të njëjtat familje përfituese dhe e njëjta vlerë, thjeshtë është bërë llogaritja gabim.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **35** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e rradhës: *“Për një ndryshim në VKB-në nr.84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër”*, i ndryshuar.

Relaton për këtë pikë **Znj.Dama**, drejtoreshë e përgjithshme juridike në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Përsëri **Znj.Shala**: Atëherë, po kërkohet një rritje stafi, pa një analizë financiare reale. Kisha dashur të di, se sa kushton kjo rritje në total dhe si është për financimin afatgjatë? Dhe përsa i përket kërkesës për psikologë dhe mësues mbështetës, sa shkolla dhe sa çerdhe mbulohen dhe sa jo? Pra mbi çfarë indikatorësh apo statistikash konkrete jeni mbështetur për të bërë këto ndryshime? A është bërë një analizë për këtë?

Përgjigjet për këtë **Z.Brahimi**, drejtor i përgjithshëm i menaxhimit të Buxhetit dhe Financës në Bashkinë Shkodër, duke thënë se në lidhje me efektet financiare për vitin 2026, vlera llogaritet

rreth 19 milion leke të reja, duke qënë se bëhet fjalë për një periudhë të pjesshme të vitit kalendarik ndërsa për vitet e ardhme shuma vlerësohet të jetë rreth 27 milion lekë shtesë.

Kurse për pjesën e dytë të pyetjes, përgjigjet **Znj.Dama**: Në lidhje me drejtorinë e arsimit që kërkohet shtim stafi, kjo bëhet në bazë të udhëzimeve përkatëse të ministrive që thotë se fëmijët me afëtësi ndryshe të trajtohen me psikologë. Aktualisht ky proces mbulohet në bashkëpunim me drejtorinë e Shërbimit social. Por fatkeqësisht për shkak të rritjes së numrit të këtyre fëmijëve dhe nevojave specifike që ato kanë, është kërkuar staf shtesë. Po ashtu edhe në lidhje me Qendren Kulturore të fëmijëve, besoj që është e sqaruar edhe në relacion, që nisur nga viti i kaluar për festivalin mbarëkombëtar të fëmijëve, është parë e nevojshme të ketë shtim stafi në mënyrë që përfaqësimi dhe standarti të jetë maksimal.

Znj.Shala: Po flasim për shtim stafi, në një kohë që infermierët e shkollave mbulohen nga Shëndeti publik, aq më tepër që para ca kohësh patëm shkurtim stafi. Prandaj dua të di, a mendoni se këto impute, këto njëzësh që po futen në punë me arsyetimin se po mbështesim fëmijët. Kjo është diçka e përgjithshme prandaj dua të di a kemi diçka konkrete, një numër të saktë fëmijësh në këtë rast? Duhet një analizë e saktë mendoj. Pastaj ndryshon numri i punjësve, ndryshon fondi. Jemi në një vit zgjedhor dhe kemi asnjë transparencë, asnjë garanci për meritokraci në rekrutimin e stafit. A thua po shkojmë drejt punësimeve politike?

Përsëri Znj.Dama: Kjo bëhet sepse është detyrim ligjor që ti kemi. Është e vërtete që ne për mungesë strukture që nuk ka qënë përpara, pra kto shërbime nuk kanë qënë përpara për psikologë dhe infermiere dhe sot kërkojmë të përfshihen në strukturë. Theksoj se për këto vende nuk ka patur shkurtime.

Znj.Shllaku: Në vijim të fjalës së koleges, doja të shtoja diçka. Vërej që në raportet që na sillni, të pakten me shtimin e numrit të punonjësve, informacioni është krejt i cunguar. Nuk kemi shifra konkrete apo arsye të sakta pse ta miratojmë. Duhet ta merrni më seriozisht këtë gjë.

Kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve ku Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehin dakordësi me projektaktin, kurse **Znj.Shala** shprehet se për arsyet e sipërpërmendura jemi kundër.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **27** vota Pro **8** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika tjetër: *“Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2025 të Bashkisë Shkodër”*.

Relaton për këtë pikë **Z.Behari**, drejtor i drejtorisë së të ardhurave në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Një analizë më të detajuar e bën edhe Znj.Haxhi, drejtoreshë Buxheti.

Fjalën e merr **Z. Bjanku** duke u shprehur se materiali i prezantuar duhet të jetë më i qartë për publikun, sepse pjesa e buxhetit ka nevojë për sqarime më të kuptueshme.

Po ashtu edhe **Znj.Shestani** thotë se shifrat nuk mund të jenë të kuptueshme për të gjithë, prandaj do ishte mirë të shihnim cilësinë e analizës, që do të thotë çfarë është arritur dhe çfarë jo, dhe nëse jo, arsyen pse?

Z.Luli sqaron se ky është formati i prezantimit, prandaj mund të kalojmë në pyetje dhe diskutime.

Znj.Golemi: Te raporti i monitorimit të buxhetit 2025 shohim se realizimi i shpenzimeve është 16.7%, ndërkohë që realizimi i të ardhurave është kaluar 100%. Pra vërehet një diferencë shumë e madhe. Po ta shohim sipas programeve vëmë re se % e realizimit të shumë programeve në pjesën e buxhetit fillestar janë të përcaktuara. Pra tek këto programe që kemi një rishikim buxheti dallojmë më shumë jorealizim. Pra edhe rialokimet që bëhen gjatë vitit nuk janë të menaxhuara si duhet. Përsa i përket investimeve të realizuara shohim që ato përbëjnë vetëm 17% të shpenzimeve bashkiake. Një pjesë e mirë e tyre janë realizim projektesh, gjë që e ul akoma më shumë vlerën. Në këtë formë duke parë që kemi vetëm 67% të realizimeve të shpenzimeve, ne përsëri edhe në 2026 ashtu si në 2025 duhet të kemi shtesë, për të kaluar në 2026 rreth 50% të buxhetit të 2025. Po kalojmë në një pikë tjetër, kishim mosrealizimin e pagave 60.7%. Si ka mundësi që pagat nuk janë realizuar? Çfarë planifikimi keni bërë në fillim të vitit për to? Gjithashtu përsa i përket të ardhurave, drejtori na permendi taksën mbi tokën bijqësore duke e paraqitur si arritje, kur në fakt është realizuar vetëm 41%. Tjetër pyetje; tek të ardhurat nga taksat për biznesin e vogël, shoh se mbledhja e tyre është 180% realizim. Atëherë, a ka rritje takes apo dyfishim biznesesh?

Përgjigjet për këtë **Z.Behari;** Përsa i përket taksës së biznesit, thjesht janë mbledhur detyrimet e prapambetura, kurse për taksën bijqësore është e vërtetë që vjelim 41.6% por ne kemi si agjent ujësjellësin dhe ju i dini problematikat që ka me lidhjen e matësive në njësitë administrative.

Në lidhje me pagat përgjigjet **Znj.Haxhi,** duke thënë se kjo ka të bëjë me indeksimin e tyre që u bë bazuar në VKM. Po ashtu ndikim kanë patur edhe disa shtesa punonjësish në gjysmën e vitit. Llogaritja për 2026 është fiks me stafin ekzistues dhe është 5% i fondit të veçantë, që jemi të detyruar ligjërisht ta kemi. Akumulimi është nga viti i kaluar.

Z.Bjanku. Faktikisht bëhet fjalë për një dokument shumë të rëndësishëm që na është sjellë, prandaj duhet të jemi sa më transparent për qytetarët se ku kanë shkuar taksat e tyre në një kohë që vjelja e tyre është e lartë, ndërkohë që realizimi i buxhetit është i ulët. Kjo shihet kryesisht tek investimet me një % shumë të vogël realizimi. Pse nuk janë realizuar investimet dhe pse masa është e tillë rreth 30%? Besoj se duhet të ketë një sqarim për këtë.

Përgjigjet **Z.Kopsaj,** drejtor i planifikimit të territorit, duke thënë se lidhur me investimet e parashikuara në 2025 në infrastrukturë, arsyeja pse nuk janë realizuar është sepse është dashur të bëhej projektimi për secilin investim. P.sh: rr. Roza Lejn është përfunduar dhe likuiduar por nuk është pasqyruar në buxhetin e 2025. Pra nuk jemi tek vlera 30% por më shumë. Kjo vlen edhe për investime të tjera. Kurse për 2026 po ju informoj që 17 investimet e parashikuara janë në fazën e tenderimit të projektimit. Nuk besoj se këtë vit do kemi pengesat e vitit të kaluar.

Kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku **Z.Ndou** dhe **Z.Sokoli** shprehin dakordësi me projektaktin, kurse **Znj.Shala** shprehet kundër për arsye që lidhen me analizën, transparencën dhe standartet e menaxhimit financiar.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **27** vota Pro **7** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 6.: “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 për Bashkinë Shkodër”.

Relaton për këtë pikë **Znj.Haxhi**, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Shala: Ne i kemi miratuar tavanet buxhetore me buxhetin në dhjetor. A mund ta dimë se cilat janë ndryshimet konkretisht?

Znj.Haxhi: Ndikim të dukshëm ka dhënë efekti I pagave, pra ky është një nga ndryshimet. Pra është rritur efekti I pagave në PBA e 2027. Politikat e asja që kemi miratuar në dhjetor janë ruajtur.

Znj.Golemi: Siç u tha nga kolegja, nëse marr një nga programet që kishte një ndryshim të madh, planifikimi i territorit, ka një ulje të konsiderueshme. Shpenzimet kapitale të brendshme ishin të planifikuara, kurse tani vijnë të ndryshuara. Gjithashtu secili nga programet ka ndryshuar. Po ashtu ka ndryshime edhe tek të ardhurat, tek transfertat e pakushtëzuar, nuk ka ndryshim kurse tek të ardhurat e vet aka rritje. Nga vjen kjo rritje?

Znj.Haxhi: Tavanet e sjellura sot, vijnë si rrjedhojë e mbledhjes së kaluar, konkretisht VKB nr.14. Pra merren të ardhurat e miratuara në mbledhjen e fundit plus transfertat që është e miratuar nga qeveria. Theksoj që ndryshimi i vetëm është efekti I pagave.

Znj.Golemi: Por kemi një ulje të vlerës...

Znj.Haxhi: Jo, nuk kemi ulje, kemi rritje prej 9.6% më tepër në raport me buxhetin e 2026.

Z.Bjanku: Kaluam më parë pjesën e realizimit, procedurë kjo nga më të rëndësishmet që kalon në Këshill. Është llogaridhënia më e rëndësishme që duhet të bëhet para Këshillit Bashkiak. Tani na paraqiten Tavanet pasi kaluam pjesën e realizimit të buxhetit, në një kohë që buxheti realizohet diku tek gjysma e tij dhe niveli i investimeve shkon diku tek 37%. Vendosja e këtyre tavanëve, i bie që i vendosim kot sepse kur vjen puna pastaj tek pjesa e procedurës së realizimit të buxhetit, ne nuk e zbatojmë atë dhe hajde tani të flasim për tavanet, që janë formalitet. Por faktikisht për pjesën e menaxhimit financiar duhet të ketë një seriozitet shumë të madh, që këto tavane më pas duke u reflektuar edhe tek pjesa e buxhetit që kalon në fund të vitit, duhet të bëhet për tu zbatuar dhe jo thjesht si një procedurë formale, si një detyrim ligjor dhe nuk ka asnjë lloj përgjegjësie për vendosjen e këtyre limiteve buxhetore dhe realizimit të tyre.

Kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehin dakordësi me projektaktin, kurse Znj.Shala shprehet kundër për mungesë serioziteti, për mos sqarim në lidhje me ndryshimet e këtyre tavanëve.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **27** vota Pro **7** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e radhës: “Për miratimin e programit të transparencës në Bashkisë Shkodër”.

Fjalën e merr **Znj.Mehmetaj** duke thënë se ajo propozon se duke qenë se bëhet fjalë për një projektvendim, që nuk ka asnjë ndryshim mund ta kalojmë pa relativitet.

Në lidhje me propozimin e Znj.Mehmetaj, Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehen pro, kurse Znj.Shala shprehet se ata duan të dijnë më tepër, duke filluar që nga mekanizmat që do përdorën për këtë transparencë.

Relaton edhe për këtë pikë **Znj.Dama**, drejtoreshë e përgjithshme juridike në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehin dakordësi me projektaktin, kurse Znj.Shala shprehet kundër duke u nisur nga fakti që transparenca nuk është vetëm dokumentacion por edhe përgjegjësi.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **27** vota Pro **6** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika 8. e rendit të ditës: *“Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në Bashkinë Shkodër për Bashkinë Shkodër”*.

Relaton **Znj,Shllaku** drejtoreshë Mjedisi në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Pyetje e diskutime për projektaktin nuk ka, kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projekt aktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **27** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e rradhës: *“Për miratimin e planit lokal, programi 5-vjeçar i strehimit social 2026-2030, në Bashkisë Shkodër”*.

Znj.Pode propozon që të kalohet pa relativim, pasi është kaluar pranë Komisionit përkatës dhe është zhvilluar edhe konsultim publik.

Në lidhje me propozimin e Znj.Pode, Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehen pro, kurse **Z.Bjanku** shprehet se duke qënë se kjo është një pikë shumë e ndjeshme, edhe për efekt transparence për të ditur se çfarë ka ndryshuar, mendoj të kemi më tepër informacion dhe sqarime.

Relaton **Znj.Kacerrri**, specialiste pranë drejtorisë së Shërbimit Social në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projekt aktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **33** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika 10.: : *“Për miratimin e planit të mbrojtjes sociale 2026-2030, në Bashkinë Shkodër”*.

Relaton për këtë pikë **Znj.Kruja**, drejtoreshë e Shërbimit Social në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projekt aktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **34** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Relaton për këtë pikë **Znj.Bërdica**, përgjegjëse pranë drejtorisë së Shërbimit Social në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr **Z.Bjanku** duke thënë se tashmë dihet një fenomen mjaft i dukshëm largimi masiv i të rinjëve dhe procesi i plakjes së popullsisë, sidomos në very të vendit dhe natyrisht që kjo prek edhe Bashkinë e Shkodrës. A e keni konstatuar këtë fenomen edhe cilat janë format që ju keni menduar ose adresuar në këtë situatë? Dhe sa është përfshirë kjo në planin që po prezantohet?

Përgjigjet **Znj.Bërdica**: Absolutisht që emigracioni është një problematikë e evidentuar në planin e rinisë. Janë marr masa si nga ana e nxitjes së sipërmarrjes me anë të skemës së garnteve. Traditë kjo e përvitshme nga Bashkia Shkodër. Aftësimi, trajnimi i të rinjëve dhe thirrje për të parë mundësi reale në vendin e tyre. Është garancia rinore, një instrument, që ne po bashkëpunojmë fort me AKPA-në, për t'i ofruar atyre mundësi trajnimi e punësimi. Ndoshta ky plan nuk është i vetmi instrument për të rinjtë, por duhet të ketë edhe politika të tjera ndërinstytucionale.

Po ashtu edhe **zv/kryetari Z.Beka**, në fjalën e tij thotë se duke u nisur edhe nga politikat për të mbështetur të rinjtë, ne kemi ndarë si politikë zhvillimi në tre sektorë kryesorë: Infrastrukturë, grantet dhe nxitja e bashkëpunimit me pjesën akademike. Presim që këtë vit të kemi edhe bashkëpunime me Qeverinë Shqiptare.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projekt aktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **34** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën tjetër: *“Për miratimin e planit vendor të veprimit në barazinë gjinore 2026-2030, në Bashkinë Shkodër”*.

Relaton për këtë pikë, **Znj.Loreta Bardeli**, përgjegjëse pranë drejtorisë së Shërbimit Social, në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Bjanku: Sa gjini janë marr parasysh në hartimin e këtij plani?

Përgjigjet **Znj.Bardeli**: Besoj që kjo kuptohet edhe nga vetë plani, vetëm dy gjini.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi me projekt aktin.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **34** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika tjetër: *Projektvendim: “Për një ndryshim në VKB-në nr.22, datë 18.04.2019 “Për miratimin e planit lokal për veprimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar të Bashkisë Shkodër”.*

Relaton përsëri **Znj,Shllaku** drejtoreshë Mjedisi në Bashkinë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimi i Kryetarëve të grupeve, ku Z.Ndou dhe Z.Sokoli shprehin dakordësi me projektaktin, kurse Znj.Shala shprehet se abstenon sepse bëhet fjalë për një plan që nuk mbron qytetarët por thjesht mat zhurmat. Është e vërtetë që keni shtuar orarin dhe dy zona në Rrjoll dhe tek Ada, por harrojmë klubet që janë midis shtëpive dhe aty decibel është në maksimal.

Përgjigjet **Znj.Shllaku** duke thënë se do ngrihet një grup pune për monitorimin dhe policia Bashkiake do jetë pjesë.

Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **27** vota Pro **0** Kundër **7** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me diskutime jashtë rendit të ditës.

Fjalën e merr Zv/Kryetarja **Znj.Qyteza**, e cila bën disa falenderime pasi nga 11 pika të rendit të ditës, thotë ajo, 7 prej tyre ishin të sektorit social prandaj falenderoj për zemërsisht të gjithë këshilltarët që kanë marrë pjesë në këshillim me publikun lidhur me planet sociale. Në mënyrë të veçantë ajo falenderon specialistët që kanë punuar me shumë përkushtim për këto plane në mbështetje të qytetarëve dhe atyre shtresave në nevojë. Po ashtu edhe partnerët që na kanë mbështetur në ekspertizën e tyre, ligjore, sociale dhe praktike, të cilat janë reflektuar në ndryshimet e bëra, që u miratuan sot unanimisht.

Znj.Shllaku: Fillimisht dua të ndalem tek një çështje tejet shqetësuese, që ka ndodhur disa ditë më parë në Shkodër (tregon foto) ku shihen qartë makinat e institucionit të Bashkisë, të përdorura për një aktivitet politik, atë të prezantimit të përfaqësuesit të ri politik. Ligji për vetëqeverisjen vendore e ka të shprehur shumë qartë që pasuritë e institucioneve vendore administrohen dhe përdoren vetëm për funksione publike dhe jo për aktivitete politike. Prandaj kërkoj një shpjegim nga ana e Bashkisë dhe situata të tilla nuk duhet të ndodhin më. Së dyti, qytetarët e Shkodrës po shohin dhe po hasim përditë problematikën e trafikut në hyrje/dalje të qytetit. Punimet në segmentin Harku i Bërdicës/Ura e Bahçallekut po ecin në ritme shumë të avashta. Siç është diskutuar disa herë këtu në Këshill nuk kemi as tabela informuese, as kur ka filluar, as kur do mbarojnë punimet. As kostot e projektit. Për pak po afrohet sezoni i verës dhe kjo do jetë shumë problematike për qytetarët e Shkodrës. Dhe lidhur me këtë, meqenëse janë prezent edhe zv/kryetarët kam një pyetje, si është menduar të menxhohet kjo situatë në sezonin e verës?

Zv/kryetari **Z.Beka** pyet se për cilat automjete bëhet fjalë...?

Znj.Shllaku: Automjetët e Shërbimeve.

Z.Beka: Nuk besoj se ky rast duhet të merret kaq gjërë... Makinat janë në shërbim të institucioneve dhe jo politikës.

Për më tepër përgjigjet **Z.Kullaj**, drejtor i ndërmarrjes së mirëmbajtjes së objekteve publike duke thënë se në stadium zhvillohen aktivitete çdo ditë dhe nuk duhet marrë që makinat tona kanë qënë në shërbim të aktivitetit politik që ju përmendni.

Znj.Shllaku: Të lutem shumë, qytetarëve shkodranë nuk mund t'i hidhni hi syve. Madje duhet t'i kërkoet falje sepse ky është fakt dhe nuk mund ta mohoni dhe ta justifikoni.

Në lidhje me pyetjen tjetër përgjigjet **Z.Beka**, duke thënë se jemi në kontakt të vazhdueshëm me firmën që po zhvillon punimet, për të marrë masa sidomos në periudhën e pikut për avancimin e punimeve, që të përballohen edhe situatat problematike gjatë fundjavave verore.

Z.Shkja: Kisha një kërkesë të lagjes Tepe. Aty është një rrugicë shumë e prishur. Banorët madje kanë bërë edhe kërkesë për këtë pranë Bashkisë. A mund të di, çfarë po bëhet për këtë?

Përgjigjet **Z.Salihi**, drejtor i ndërmarrjes së shërbimeve publike: Rrugica në fjalë ka nevojë për investim, kemi bërë matjet e nevojshme, është përfshirë edhe në planifikim, por momentalisht po punojmë në disa rrugë më prioritare, si p.sh rruga e "Veksharit". Por theksoj që është vlerësuar dhe do ndërhyhet në një moment të dytë.

Znj.Gjekaj: Duke patur parasysh që tashmë po mbushim vitin e tretë të këtij Këshilli, e shoh të arsyeshme që të ngre një kërkesë tjetër, që në fakt unë do t'ja prezantoj Këshillit me shkrim sepse do doja të përfshihej në mbledhjen e ardhshme të Këshillit bashkiak. Bëhet fjalë për një kërkesë për interprellancë përsëri. Jam e kënaqur që iniciativat e mia janë marrë si precedent pozitiv duke u përdorur edhe në këshillat e tjerë të veriut. Gjithsesi këtë herë, kjo interprellancë vjen si nevojë për ligjin 55 të vitit 2025 për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa. Do doja që në mbledhjen e ardhshme të kishim prezent përfaqësues nga Bashkia për këtë, që të bëheshin pyetje dhe të shohim edhe një plan lidhur me këtë. Të gjithë jemi të vetëdijshëm të se sa probleme ka lidhur me bashkëjetesën në ndërtesa, konflikte jo të rralla. Dua të theksoj që Bashkia Shkodër nuk është aktori kryesor për rregullimin, por ligji i ka lënë kompetencë për të qënë një aktor ndërhyrës në rastet kur nuk ka dakordësi apo nuk ka administratorë. Mendoj që ka ardhur koha që të merret një hap pozitiv nga ana e administratës së Bashkisë në lidhje me këtë ligj për t'i ardhur në shërbim komunitetit dhe duke shmangur edhe konfliktet të mundshme.

Z.Behri ngre një shqetësim të 9 familjeve të njësisë administrative Bërdicë, që nuk po gjejnë zgjidhje lidhur me tokat e tyre që i janë marr për rikonstruksionin e rrugës tek Harku i Bërdicës-

Velipojë. Rrugë kjo e përfunduar që në 2019 dhe shpronësimi nuk është bërë akoma. Nga ana e Bashkisë i është bërë kërkesë Agjencisë shtetërore të shpronësimeve por qytetarët nuk kanë marr akoma përgjigje.

Përgjigjet Z.Preka: Për rastin në fjalë ka patur problematika me hartat dhe është bërë një përditësim i zonës prandaj ka patur vonesa. Është përcjellë i gjithë dokumentacioni tek Agjencia shtetërore e shpronësimeve dhe tani ka një procedurë që do ndiqet në vazhdim. Jemi në pritje të përgjigjes dhe daljes së vendimit për shpronësim.

Vijon Z.Behri: Përsa i përket szonit veror në Velipojë që është në prag do doja informacion për rrugën që kemi miratuar në 2024. Kur mund të fillojë ajo rrugë, a është e mundur të kryhet para sezonit që të shmanget kaosi nga trafiku? Po ashtu kur do ndërhyhet tek rehabilitimi i shatërvanit në qendër të Velipojës?

Përsëri Z.Preka: Përsa i përket rrugës jemi në fazën e vlerësimit të ofertave dhe me daljen e firmës fituese do të shihet mundësia për të filluar punimet pa penguar sezonin. Edhe për shatërvanin do shihet mundësia e një ndërhyrjeje përfundimtare.

Znj.Shala: Ka shumë herë që në mbledhjet e kaluara kam bërë tre kërkesa, ku kërkoj përgjigje. Më është thënë se do ta japim përgjigjen në mbledhjen e ardhshme por akoma asgjë. Kërkesat e mia janë lidhur me plazhet publike, në Velipojë se si është menaxhuar dhe çdo gjë që lidhet me të. Si dhe festat e fundvitit për shtëpizat druri dhe po ashtu për aktivitetin e shoqërisë “Skodrinon”. Pyetje këtë të bëra disa herë dhe të mbetura pa përgjigje.

Në vijim të pyetjes së kolegut, në lidhje me rrugën e Velipojës. Kur është diskutuar në fillim ka qenë edhe Kryetari prezent. Ajo është një rrugë që nuk parashikon asnjë vend parkim makinash në vijën e parë ku ka patur gjithmonë, sepse është kthyer në lulishte. Kryetari aso kohe tha se do ketë parkingje në zonë. A është normale të bëhet kjo rrugë pa patur sipërfaqe për parking. Rruga është me një sens, a keni menduar që një ambulancë që do vi për të dhënë shërbim, ku do të parkojë, në një kohë që do bëhet korsi biçikletash 2.5 m.

Unë pëgëzoj për rrugën por normalisht për të qenë efçente ajo rrugë duhet të kemi parasysh disa gjëra.

Z.Preka: Përsa i përket vendparkimeve, patjetër që Velipoja do ketë dy vendparkime publike sivjet dhe do shihet mundësia edhe për t'i zgjeruar. Përsa i përket projektit të rrugës dua të them se aty nuk parkohen makina, ajo është rrugë që do të lidhin të gjithë ato biznese aty për të lehtësuar qarkullimin.

Replikon Znj.Shala: Aty në njërën anë parkohen makina dhe nuk ka askund vend për të parkuar. Nuk duhet të harrojmë që Velipoja është plazh relativisht i përbalueshëm ekonomikisht dhe t'i heqësh edhe vendparkimet dhe të shkosh në këmbë deri në plazh nuk duket gjë e mirë.

Znj.Golemi: Kisha një kërkesë për rugën tek “Banja e vogël”, është një rrugë me dy kalime, ku parkohen makina në një krah, njëkohësisht trotualet janë shumë të ngushta dhe rruga me shumë gropa. Ndoshta rikonstruksioni i saj kërkon buxhet tjetër por të pakten të riparohen gropat.

Përgjigjet **Z.Salihi:** Pjesa e rrugës aty që ka marr pallati për ndërtime do të mbyllet brenda javës kurse pjesa i përket gropave sot duhet të ketë filluar hapja e tyre për riparim. Maksimumi për 10 ditë do mbyllen.

Z.Bjanku: Po ngre një situatë lidhur me trafikun tek këto rrugët me një sens. Kjo edhe në kuadër të kompetencave tona në kuadër të kompetencave tona si Këshill Bashkiak.

A mund të dimë këto vendimmarrje si po realizohen sepse po shohim që mdryshojnë herë pas here edhe pa një studim të mirë. Marr shkas këtu nga rruga Parucë-Xhabije. Kam një kërkesë të vazhdueshme edhe nga një qytetar, pse bulevardi “Skenderbeu” nuk ka korsitë biçikletash? Nuk e di me çfarë standarti vendoset, qoftë edhe për të sqaruar qytetarët.

Përgjigjet **Z.Beka:** Se si realizohet kjo? Ne po fillojmë aplikimin e planit të mobilitetit. Dhe ky plan e ka parashikuar me dy sense rrugë që përmendet. Me rregullimin e fasadave, imazhit dhe vendosjen në qarkullim të autobuzit, që mendoj është një element i mirë për Shkodrën. Kjo ishte edhe arsyeja që u kthye me dy sense dhe kjo është mirëpritur. Kurse për sheshin “Demokracia” edhe aty ka një plan për lëvizshmërinë dhe parashikimin e një korsie biçikletash. Po shohim edhe mundësinë e një parkimi me pagesë. Kemi një propozim për një aplikacion të ri, i cili përveç se gjeneron të ardhura krijon edhe mundësi parkimi. Jemi në fazën përfundimtare të marrjes së koncept ideve dhe shumë shpejt do t’jua prezantojmë edhe ju.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka.


*Kryetari e Këshillit **Z.Luli** e deklaroi mbledhjen të mbyllur.*

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 30.03.2026. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 13 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Sabina DANAJ



Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti

